

Fillimi > -Kronikë

Me automatik, shotgun dhe 30 fishekë në makinë, arrestohet 20-vjeçari nga Bulqiza dhe 2 shokët nga Tirana

28 Nëntor, 2020 10:07 | 2 301 shfletime



Madhësia e tekstit: - +

BULQIZË

Policia e Bulqizës ka goditur një tjetër rast të armëmbajtjes pa leje duke arrestuar tre të rinj.

Shërbimet e Komisarariatit të Policisë Bulqizë, në zbatim të planit të masave për mbajtjen nën kontroll të personave me tendenca kriminale, kapjen e personave në kërkim dhe atyre që qarkullojnë me armë zjarri pa leje, kanë intensifikuar punën dhe dhe si rezultat i kontrolleve të shtuara kanë arrestuar në flagrancë shtetasin Denion Fiku, 20 vjeç, banues në Bulqizë.

Kapja e tij u bë nga shërbimet e Policisë, në vendin e quajtur “Sektori Dushaj”, ku ai po qarkullonte në automjet me dy shokë të tij nga Tirana.

Nga kontrolli i imtësishëm i automjetit u gjetën të fshehura një armë zjarri automatik, një armë gjahu shotgun dhe 30 fishekë, të cilët u sekuestruan në cilësinë e provës materiale.

Në përfundim të veprimeve të para hetimore u bë arrestimi i shtetasit D. F., për veprat penale “Mbajtja pa leje e armëve luftarake” dhe “Mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë”; Saimir Hallaçi, 24 vjeç dhe Andi Çuni, 25 vjeç, të dy banues në Tiranë, për veprën penale “Moskallëzimi i krimit”.

Strukturat hetimore të DVP Dibër, në bashkëpunim me Prokurorinë Dibër, vijnë hetimet për zbardhjen e veprimeve që do të kryenin këta persona që u kapën duke qarkulluar me armë zjarri.

Materialet procedurale në ngarkim të këtyre shtetasve i kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Dibër, për veprime të mëtejshme.

Për t'u bërë pjesë e grupit "Balkanweb" mjafton të klikoni: [Join Group](#) dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. [Grupi Balkanweb](#)

Etiketa: arme zjarri bulqize


TË NGJASHME

Itali/ Policia arreston 100 trafikantë të dyshuar droge
24 Nëntor, 2020

Kallashnikov, drogë e municion luftarak, arrestohen dy të rinj në Kukës
10 Nëntor, 2020

Shfaq Komentet (0)

TË FUNDIT NGA -KRONIKË



VIDEO/ Pamjet nga aksidenti tragjik në Golem, trupi i motoristit merret me barelë...
30 Nëntor, 2020



Aksidenti me një të vdekur në Golem, policia: Në motor edhe një pasagjere, u dërgua në spitalin e Durrësit
30 Nëntor, 2020



Aksident i rëndë në Golem, furgoni përplasat me motorin në autostradë, ndërrohet drejtuesi (EMRI)
30 Nëntor, 2020

Aksident në Ersekë/ Plagoset rëndë një person, dërgohet me urgjencë në spital
30 Nëntor, 2020

“Nuk kemi asnjë përgjigje nga analizat”, flet vëllai i pacientit që u hodh nga Covid2: I thash ‘mos shko në spital’, motrës i rrëfeu se ...
30 Nëntor, 2020

I infektuar me Covid-19, vlonjati tenton të kalojë Kakavijë, gjobitet me 700 mijë lekë
30 Nëntor, 2020

KATEGORIA VIDEO



VIDEO/ Pamjet nga aksidenti tragjik në Golem, trupi i motoristit merret me barelë...
30 Nëntor, 2020



Kur Haga shpallte të pastër luftën e UÇK-së 18 vite më parë/ Lirimi i Fatmir Limaj dhe pritja madhështore në Kosovë
30 Nëntor, 2020

Këngë nga e gjithë bota, çifti Janaqi propozojnë menunë me 2000 këngë për ndjekësit
30 Nëntor, 2020

30 Nëntor, 2020

“Gënjeshtra i shkon për shtat”, Jorida Tabaku: Ja si Rama po i bën rrush e kumbulla taksat e shqiptarëve
29 Nëntor, 2020

“Tentuan të më digjinin të gjallë, gjeta dy shishe benzinë"/ 52-vjeçarja rrëfen divorcin: Ndihej me kërcënuar, kërkoj ndihmën e shtetit

Aksident në Berat/Fuoristrada del nga rruga, për pak sa nuk përfundon në lumë. Shpëton mrekullisht shoferi (VIDEO)
29 Nëntor, 2020